


Letër familjes

I dashur nxënës, të dashur familjarë,

Grafikët i shihni kudo – në faqen sportive të gazetës, në reklama, në librat shkollorë të shkencave natyrore dhe shoqërore! Shumë nga këta grafikë janë grafikë vijorë, grafikë shtyllorë ose grafikë rrethorë. Në këtë kapitull, do të mësoni për grafikë që përdorin pika dhe vija për të treguar rregulla dhe marrëdhënie midis të dhënave.

Ja një shembull. Ky grafik ka një bosht horizontal dhe një bosht vertikal. Tregon çmime paketash të ndryshme sheqeri. Në bazë të këtij grafiku, mund të përcaktoni fakte të tilla si:

- D është më e rënda.
- B dhe F kanë të njëjtën peshë.
- C , E , dhe D janë më të rënda se B .
- E dhe F kushtojnë më shumë se D .
- C është më me leverdi për t'u blerë sesa B , meqë ka më shumë sheqer, ndërsa kushton vetëm pak më shumë.



Në këtë kapitull, do të vizatoni grafikë që u përgjigjen situatave nga më të ndryshmet. Disa grafikë, si ai më sipër, nuk kanë vlera numerike. Të tjera do të kenë shkallë ose sekuenca numrash, përgjatë secilit bosht.

Fjalor Ndërsa studioni këto lloje të reja grafikësh, do të mësoni edhe disa terma të rinj:

boshte	grafik vijor	originë
koordinata	çift koordinatash	ndryshore

Çfarë mund të bëni në shtëpi?

Gjatë javëve të ardhshme, nxënësi mund të tregojë interes për grafikët. Ndihmoheni të gjejë shembuj që tregojnë si përdoren grafikët në jetën e përditshme, duke kërkuar në gazeta dhe revista. Nxiteni fëmijën të shpjegojë se çfarë tregon një grafik i caktuar, si dhe të tregojë vlerat për pika të veçanta në grafik.